



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:126116
Datë: 13.02.2020
Numri i dokumentit: 00830430

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.1005/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm- Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri në çështjen penale kundër të pandehurit F.B., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim i armeve nga neni 328 par.1 të KPK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1473/19 të datës 19.09.2019 në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 06.02.2020, në të njëjtën datë, në mungesë të prokurores, e në prezencë të të pandehurit F.B., ka shpallur publikisht, ndërsa me 13.02.2020 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: F.B., nga i ati E. dhe e ëma F., e vajzërisë Xh., “data e lindjes”..., me nr. personal..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, babë i pesë fëmijëve, i pa pune, i gjendjes së dobët ekonomike, me parë të pa dënuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datën 18.07.2010 rreth orës 20:40 në Mitrovicë, e ka përdorur armen pa leje të vlefshme për të marrë arme, sipas ligjit për arme të RK, neni 4 par.1 pika 1.1 nën pika 1.1.2 e 1.2.12, në atë mënyrë që në aheng të vëllait të tijë ka gjuajtur në ajër nga revolva e pastaj me rastin e kontrollit-bastisjes nga ana e policisë së patrullës është gjetur në shtëpinë e tijë arma dhe atë: 1 revole e markës “Ekol Special 99” e kalibrit 9mm P.A.K. me numër serik EV-970510, dhe një karikator të zbrazet të cilat në atë rast i an marre,

Me këtë ka kryer veprën penale- **Mbajtja në pronësi kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.1 KPK-se**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 3,6,11,34,41,42,43,44,64 dhe 328 par.1 KPK-se dhe nenit 365, 450, të KPP-ës E:

G J Y K O N

ME DENIM ME BURG ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

Ne mbështetje te nenit 328 par.5 e lidhur me nenin 54 të KPK-së dhe nenin 282 par.2 nenpar.2.1 të KPP-se, të pandehurit i shqiptohet:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskimi i sendeve dhe atë:

Një pistoletë e tipit "Ekol Special 99" te kalibrit 9mm, me nr. serik EV-970510 dhe një karikator te zbrazet.

Urdhërohet Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, sendet e konfiskuar t'i shkatërroj.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te kimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuze PP.II.nr.1473/19 te datës 19.09.2019 kundër te pandehurit F.B., për shkak te veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll, apo posedim i armeve nga neni 328 par.1 te KPK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 06.02.2020 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e ndjej veten fajtor për veprën penale qe me vihet ne barre, dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur dhe kam gabuar me nuk do ta përsërisë dhe as qe e kam përsëritur nga ky rast qe ka ndodhur, i propozoj gjykatës qe te me shqiptoj nje dënim sa me te bute ngase jam i gjendjes se dobët ekonomike , dhe askush ne familjen time nuk punon.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja deklaroi: konsideroj se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 te KPPK-se, se pranimi është bere ne mënyre vullnetare pa presion andaj gjykatës i propozoj qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit dhe kjo te jete rrethane lehtësuese gjate shqiptimit te dënimit.

II. Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza si: raporti policor me nr.2010-BC-1046 i datës 03.08.2010, shënimi zyrtar i datës 18.07.2010, deklarata e te pandehurit e datës 18.07.2010, vërtetimi mbi konfiskimin e mjetit te datës 18.07.2010, procesverbali mbi bastisjen i datës 21.07.2010, si dhe fotodokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lendes. Te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat.

III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me dënim me gjobe deri ne 10.000 euro dhe me dënim me burgim prej 1 deri ne 10 vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale, si rrethane tjetër renduese është edhe fakti qe i njëjti ka poseduar arme pa leje duke rene ne kundërshtim me ligjin.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, i njëjti është mbajtës i familjes e po ashtu ka pese fëmije dhe është i gjendjes se dobët ekonomike, si rrethane tjetër gjykata ka marre edhe faktin se qe nga kryerja e kësaj vepre penale e deri ne gjykimin e kësaj vepre ka kaluar një kohe e gjate, si rrethanë tjetër lehtësuese është edhe pranimi i fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë rezulton se ai edhe vet deklaronte se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton dënimi i shqiptuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi qe do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat ligjore lidhur me shqiptimin e dënimit plotësues, ashtu qe ne baze te dispozitës 328 par 5 ne lidhje me nenin 54 te KPPK-se, ku përcaktohet se armët qe barten pa leje dhe pa autorizim e ne kundërshtim ne rrethana dhe kushtet për lejen e armës te njëjtat konfiskohen, e nen këto rrethana gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata konstatoi se nuk kishte kërkesë pasurore juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.1005/2019 dt.13.02.2020

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, e nëpërmes kësaj gjykate.